

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të Ligjit të Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 141, paragrafi (13) nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-4307/1 datë 18.10.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.02-4359/4 datë 24.10.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 40-të mbajtur më 24.10.2024, miratoi si në vijim:

Aktvendim për vërejtje publike dhe përjashtim të ritransmetimit të shërbimeve programore

1. **PUBLIKISHT PARALAJMËROHET** operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria për tregti dhe shërbime MTEL SHPKNJP Shkup, për shkak të ritransmetimit të shërbimit programor që nuk është i regjistruar në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në pajtim me nenin 141 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV).

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është specifikuar dhe në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-4307/1 datë 18.10.2024, që është pjesë përbërëse e këtij vendimi si Shtojcë nr.1.

2. **URDHËROHET** që operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria për tregti dhe shërbime MTEL SHPKNJP Shkup, menjëherë pas pranimit të këtij aktvendimi të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV, gjegjësisht të përjashton ritransmetimin e shërbimeve programore.

3. Të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi ka vepruar sipas aktvendimit për vërejtje publike dhe për përjashtimin e ritransmetimit të shërbimeve programore.

4. Nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, nuk vepron sipas aktvendimit, pra vazhdon të kryejë shkeljen për të cilën është paralajmëruar publikisht, Agjencia në pajtim me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 2 të LSHMAAV, do të paraqesë kërkesë për iniciimin e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente.

5. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij llogaritet dita e çertifikimit në arkivin e Agjencisë.

A r s y e t i m

Agjencia në pajtim me nenin 6, paragrafi (1), nënparagrafi 4 të LSHMAAV ndërmerr masa në pajtim me këtë ligj në rastet kur ka shkelje të dispozitave të LSHMAAV ose rregulloreve të miratuara në bazë të Ligjit dhe kushteve dhe detyrimeve për lejet.

Në bazë të nenit 28 të LSHMAAV, Agjencia është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë, si dhe të paketave programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjetet publike të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit me dispozitat e këtij ligji, lejet, çertifikatat e dhëna për regjistrim, aktet nënligjore dhe aktet e tjera të miratuara nga Agjencia.

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, dhe në pajtim me nenin 27 dhe nenin 28 të LSHMAAV, Agjencia më 16.10.2024, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore të pakos programore të ritransmetuar nga operatori Shoqëria për tregti dhe shërbime MTEL SHPKNJP Shkup, nga ku është konstatuar se operatori në fjalë që sipas notifikacionit nga Agjencia për komunikime elektronike mund të kryej veprimtari në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, më 16.10.2024, për përdoruesit e tij ka ritransmetuar shërbime programore që nuk mbulohej me çertifikatë për regjistrimin e shërbimeve programore të dhënë nga Agjencia, e cila është në kundërshtim me nenin 141 të LSHMAAV. Konstatimet nga mbikëqyrja janë detajisht të specifikuar në Raportin me shkrim për

mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.11-4307/1 datë 18.10.2024, që është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Rrjedhimisht nga sa mësipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 141, paragrafi (13) nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-4307/1 datë 18.10.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.02-4359/4 datë 24.10.2024 për konstatim të mos respektimit të dispozitave të LSHMAAV të cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë, miratoi aktvendimin, ku ndaj subjektit në fjalë të ndërmerret masë vërejtje publike dhe urdhërohet menjëherë pas pranimi të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV, në mënyrë që të përjashtohet ritransmetimi i shërbimeve programore.

Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti në fjalë ka vepruar sipas urdhrit, gjegjësisht sipas vërejtjes publike dhe ka ndërprerë me ritransmetim të shërbimeve programore.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky aktvendim është përfundimtar dhe kundër tij operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik mund të ngrëjë padi për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.11-4307/1 datë 18.10.2024.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.